



NJOFTIM PËR TË GJITHË KREDITORËT DHE PRONARËT E NDËRMARRJES

PRN208 "Stacioni i Veterinës" Prishtinë

- *OBPB Stacioni i Veterinës në Prishtinë Fi 1150/91.*

- *1982 OPB, Veprimtaria Veterinare e Kosovës, OBPB Stacioni i Veterinës Prishtinë Fi 307/82.*

- *1999 Klinika e Mjeksisë Veterinare - KMV "Veterina" (Regjistrimi i UNMIK).*

Në bazë të nenit 9 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe nenit 7 të Shtojcës të këtij ligji, **NJOFTOHENI** se Likuidimi i Ndërmarrjes së lartpërmendur ka filluar me datë 15 janar 2024 në bazë të vendimit të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të datës 21 dhjetor 2023.

Çdo person i cili pretendon se ka të drejtë kërkesë dhe/apo interesi ndaj kësaj ndërmarrjeje apo aseti të ndërmarrjes duhet të parashtrorë Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit sipas nenit 7 dhe nenit 23 të Shtojcës të Ligjit Nr. 04/L-034 për AKP-në.

Afati për parashtrimin e kërkesave kreditore fillon me datë 22 janar 2024 dhe përfundon me datë 7 mars 2024 në orën 16:00.

Ftoheni që të parashtroni Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit pavarësisht nëse më herët mund ta keni informuar Agjencinë Kosovare të Privatizimit apo pararendësin e saj. Nëse nuk parashtroni Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit brenda afatit kohor të lartë cekur, pretendimet tuaja do të refuzohen si të papranueshme bazuar në nenin 35 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034 për AKP-në. Mosdorëzimi i dokumentacionit në mbështetje së kërkesës tuaj apo mosplotësimi i rregullt i formularëve, gjithashtu do të rezultojë në refuzimin e pretendimeve tuaja.

Formularët për Dëshminë e Kërkesës si dhe Dëshminë e Interesit mund të merren në të gjitha zyrat e AKP-së dhe duhet të dorëzohen në Zyrën Rajonale të AKP-së çdo ditë pune nga ora 10:00 deri në ora 14:00 në adresën si më poshtë.

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Zyra Rajonale në Prishtinë
Rr. Dritan Hoxha, nr. 55, Lakrishtë
10 000, Prishtinë
Telefoni: +383 (38) 500 400
Fax: +383 (38) 248 076

Formularët për parashtrim të Dëshmisë së Kërkesës dhe Dëshmisë së Interesit gjithashtu mund të shkarkohen edhe nga faqja e internetit të AKP-së në adresën www.pak-ks.org. Për udhëzime se si të plotësohen dhe dorëzohen këta formularë referohuni tek seksioni "**Formularët-Udhëzime për plotësim**". Formularët e dorëzuar përmes postës elektronike nuk do të pranohen.